

NDERIM MIKUT TË SHTRENJTË DHE KRITIKUT MENDJEMPREHTË

Agim VINCA

Fakulteti i Filologjisë
Prishtinë

Bajram Krasniqin e kam pasur fillimisht student, pastaj edhe koleg dhe mik.

I takonte brezit të parë të studentëve që u kam dhënë mësim si asistent në Fakultetin e atëhershëm Filozofik (në vitin akademik 1972/73), brez në të cilin bënin pjesë, përveç tij, edhe Arif Demolli, Rushit Ramabaja, Sylejman Sylja e të tjerë.

Bajrami ishte më i riu ndër ta, por shquhej me një pjekuri e zgjuarsi të pazakonshme.

Kam pasur kënaqësinë ta njoh nga afër si njeri, me të gjitha vlerat dhe tiparet e tij njerëzore e, ç'është më me rëndësi, ta njoh, ta lexoj e studioj, pak a shumë, veprën e tij shkencore, së cilës i jam referuar herë pas here në punën time si studiues i letërsisë dhe ligjërues shumëvjeçar i saj.

Bajram Krasniqi la pas vetes një opus krijues prej pesë veprash nga fusha e kritikës letrare dhe e studimit të letërsisë: *Komunikime letrare* (1980), *Letërsia dhe vetëdija historike* (1984), *Poetika e romanit historik shqiptar* (1985), *Kode të ligjërimit letrar* (1988) dhe *Inteligjencia, letërsia dhe realiteti* (1996), katër prej të cilave u botuan për të gjallë të autorit, ndërsa e pesta pas vdekjes së tij.

Nga datat e botimit të librave të tij, mund të shihet se ai e ushtroi intensivisht punën e vet krijuese në një periudhë prej rreth një deкаде, në mos edhe më pak.

Dhe, siç kam theksuar edhe në një rast tjetër, njeriu mund të bëhet poet i mirë, madje edhe i shquar, natyrisht nëse ka talent, brenda një periudhe të shkurtër a relativisht të shkurtër kohore, siç ka ndodhur, fjala vjen, me Migjenin tek ne, me Rembonë te francezët, me Petëfin te hungarezët, me Shelin e Bajronin te anglezët, apo edhe me Pushkinin e Lermontovin te rusët, por për t'u bërë studiues i spikatur i letërsisë, njeri që bën sinteza të mëdha shkencore, duhet pak më shumë kohë.

Jeta nuk ia dha këtë mundësi mikut dhe kolegut tonë Bajram Krasniqi, sikurse edhe ndonjë tjetri para tij (kam parasysh në radhë të parë kritikun e talentuar Drago Siliqi, i cili vdiq tragjikisht, në një aksident trafiku ajror, në moshën 33 vjeçare), por Bajrami arriti që brenda harkut kohor prej 10-15 vjetësh, nga 39 sa jetoj gjithsej, të dëshmohej si studiues i rrallë i letërsisë sonë kombëtare - letërsisë shqipe, në plan sinkronik e diakronik, me të gjitha specifikat e zhvillimit të saj atipik.

Hyrja në Institutin Albanologjik, në vitin 1975, i dha impuls punës së tij kërkimore, duke ia bërë të mundur të krijonte edhe vepra me karakter monografik, çfarë është *Poetika e romanit historik shqiptar*, që ishte teza e tij e doktoratës, e mbrojtur në vitin 1983 dhe e botuar si libër në vitin 1985. Kjo vepër paraqet një studim të gjerë, të thelluar e modern, mbi romanin historik shqiptar, prej fillimeve të tij, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, e deri në vitet '80 të shekullit XX. Duke iu përmbajtur kriterit të strukturës së brendshme, pra të poetikës, në kuadër të romanit historik shqiptar, autori hetonte këta tipa të romanit: romanin pseudohistorik, romanin-epope, romanin e personazhit, tipin e romanit që oscilon "mes historisë së letrarizuar dhe letërsisë me subjekt historik" dhe romanin me prirje moderne.

Mund të thuhet se fushë e specializimit të tij ishte romani dhe posaçërisht romani historik, por me studimet e tij në librat *Letërsia dhe vetëdija historike* dhe *Kode të ligjërit letrar*, ai dëshmoi se kishte afinitet edhe për poezinë dhe dramën (kur them kështu kam parasysh studimin e tij të hershëm për lirikën e Kadaresë dhe sidomos interpretimin e shkëlqyeshëm të vëllimit poetik *Jeta gabon* të Rahman Dedajt dhe të dramave të librit *Mite të zhveshura* të Prof. Qosjes) dhe, natyrisht edhe për kritikën, që ishte vokacioni i tij kryesor.

Bajram Krasniqi ishte njeri me interesime të gjera. Prirja e tij për t'u marrë me letërsinë, me studimin e saj, ra në sy qysh kur ishte student, por shpërtheu plotësisht në vitet '70, kur në Kosovë u krijuan rrethana më të

favorshme për punë krijuese, veçanërisht në fushën e albanologjisë, çfarë ishte komunikimi kulturor në relacionin Tiranë-Prishtinë dhe anasjelltas. Falë punës dhe talentit të tij, por edhe këtyre rrethanave, Bajrami arriti të formohej si një studiues serioz e kompetent, fjala e të cilit dëgjohej me respekt.

Vdekja e parakohshme, më 9 nëntor 1990, në moshën 39 vjeçare, ia ndërpreu hovin krijues Bajram Krasniqit. Sot, kur po e përkujtojmë, në shtëpinë ku ai e kaloi pjesën më të frytshme të jetës së tij, na duket e pabesueshme se kaluan njëzet e pesë vjet, pra plot një çerek shekulli qysh se ai u nda nga ne. Njerëzit vdesin, veprat mbesin. Jo vetëm pse është zakon të thuhet, por pse është vërtet ashtu; vepra e Bajram Krasniqit është e gjallë dhe komunikon edhe sot me lexuesit.

Shkrimet e Bajram Krasniqit për letërsinë shqipe dhe veçanërisht ato për romanin shqiptar jo vetëm që nuk e kanë humbur vlerën e tyre, por mund të thuhet, madje, se kanë fituar në peshë sidomos tani në kohën e degradimit të kritikës letrare ndër ne; në kohën kur spekulohet aq shumë me dijen dhe kur merren aq lehtë dhe shpejt titujt, gradat, çmimet, jo rrallë edhe pa i merituar.

Bajrami i takonte grupit të studiuesve që e modernizuan kritikën shqipe dhe e afirmuan modelin kritik të të menduarit mbi letërsinë. Në një shkrim mbi studimin struktural të letërsisë, theksonte se me hapjen e studimeve pasuniversitare në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës dhe me themelimin e Degës së Letërsisë në Institutin Albanologjik, u bë i mundur konstituimi i një shkolle letrare me bazë poetikën strukturale historike.

Bajrami i njihte mirë ose relativisht mirë teoritë dhe metodat moderne të studimit të letërsisë, si: semiologjinë dhe strukturalizmin (kujto trajtesën *Studimi struktural i letërsisë*); teorinë e receptimit të Jausit, teorinë e toposeve të Kurciusit, por edhe teorinë e romanit të Lluçit, e të tjera. Ai diti të përfitonte nga përvoja, mjetet dhe instrumentet e këtyre metodave kritike, por nuk e fetishizonte asnjërën prej tyre.

Shikuar nga ky aspekt do të mund të thuhet se ai ishte me një këmbë në narratologji të tipit Todorov, me tjetrën në semiotikë a la Lotman, kurse me të dyja në poetikën strukturale historike, që veprën letrare e sheh si tekst gjuhësor artistik, por edhe në kontekst historik.

Bajrami ishte studiues me formim të mirëfilltë teorik, me koncept të qartë për letërsinë, që e zotëronte mirë metodologjinë e punës shkencore, si dhe gjuhën në të cilën shkruante, gjuhën letrare shqipe. Ndryshe nga disa "xhokerë të dijes", si i quante ai me ironi, ai kishte aftësinë që dijen e aku-

muluar nga librat ta zbatonte në punën e tij “praktike”, të themi kështu: në interpretimin e veprave të letërsisë shqipe, veçanërisht të romanit shqiptar dhe të prozës në përgjithësi, që ishte lloji letrar me të cilin u mor më me përkushtim.

Vdekja e hershme e ndërpreu punën e tij të frytshme në studimin e letërsisë shqipe.

Po të jetonte më gjatë, Bajrami do ta kishte pasuruar bibliografinë e tij me vepra të reja, duke i dhuruar shkencës shqiptare të letërsisë kontribute të reja shkencore. Por le të më lejohet me këtë rast të bëj edhe një supozim. Po të jetonte më gjatë, Bajrami do të ishte joshur edhe nga forma të tjera të krijimtarisë, pos kritikës letrare dhe studimit historiko-letrar të letërsisë, dhe në radhë të parë nga proza dhe publicistika. Them proza, sepse ai ishte kritik kreativ, që edhe kritikën letrare e shkruante me invencion, por edhe publicistika, sepse, me natyrën që kishte, nuk do të mund të ishte indiferent ndaj zhvillimeve që e përshkuan Kosovën dhe mbarë Kombën shqiptar në këta 25 vjet.

Bajram Krasniqi nuk ishte kritik i mbyllur në “kullën e fildishtë” të kodeve dhe strukturave, ai ishte njeri dhe intelektual që jetonte me fatin e popullit të vet. Në një intervistë të vitit 1987, flet për të ashtuquajturin “cinizëm estetik”, përkatësisht “eskapizëm politik”, duke shprehur mospajtimin e vet kategorik me kategorinë e krijuesve dhe intelektualëve snobë e pseudoavangardë, që mbajnë qëndrimin indiferent ndaj jetës së përditshme dhe problemeve në shoqëri. Shkrimet e tij të fundit, të përfshira në librin postum *Inteligjencia, letërsia dhe realiteti*, janë reagime intelektuale ndaj krizës që pat kapluar shoqërinë e kohës dhe ndaj albanofobisë në rritje, fillimisht në hapësirën mediatike jugosllave, e cila, pa kaluar shumë kohë, u bë politike shtetërore.

Me Bajram Krasniqin mund të bisedoje seriozisht për probleme të mëdha të jetës dhe për krijues të mëdhenj të artit dhe të shkencës; mund të qaje halle me të, por edhe të qeshje e të bëje shaka, sepse ai kishte, ndër të tjera, edhe një sens të hollë për humor. E, humori, siç thotë shkrimtari i madh anglez, Uilliam Thekerej, është: sintezë e mendjemprehtësisë dhe e dashurisë për njerëzit. Bajram Krasniqi i kishte të dyja këto dhunti: ishte i zgjuar e mendjemprehtë dhe i donte njerëzit, edhe atëherë kur i kritikonte dhe nuk pajtohej me veprimet e tyre jo të mira.

Bajrami ishte më i miri ndër ne.